REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 326, Datë 03.11.2026

MBI

REGJISTRIMIN E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "3X ENERGY" SH.P.K.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 6 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 230, datë 18.08.2026; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2958/3 prot., datë 03.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "3X Energy" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

- Shoqëria "3X ENERGY" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2239 prot., datë 27.07.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 70 MW. Në këtë aplikim është kërkuar edhe përfshirja e veprave ndihmëse, duke sqaruar se sistemi i akumulimit të energjisë me kapacitet energjetik depozitimi 144.003 MWh, nuk synon rritjen e kapacitetit të prodhimit apo të injektimit të energjisë elektrike në rrjet, por optimizimin e operimit të centralit fotovoltaik, brenda kufijve të kapacitetit të pritshëm të licencuar prej 70 MW.
- Në vijim të procedurës së sipërcituar, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 262, datë 11.09.2026, ka vendosur licencimin e shoqërisë "3X ENERGY" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 70 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3268, Fshati Saver, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.
- Në konstatimet e këtij vendimi është vlerësuar, ndër të tjera, se në përputhje me qëndrimin e shprehur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me shkresën e saj nr. 2239/7 prot., datë 03.09.2026, parashikimet e nenit 51 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe përcaktimet e "*Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026, informacioni dhe dokumentacioni i administruar në kuadër të procedurës së licencimit mund të përdoret për qëllime të njoftimit dhe regjistrimit

të njësive të depozitimit, duke u plotësuar, sipas rastit, me dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ERE.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2958 prot., datë 05.10.2026, shoqëria ka bërë me dije se është në pritje të pajisjes me licencë nga ERE për njësitë BESS, si pjesë e Veprave Ndihmëse, ose të amendimit të Aneksit A të licencës së prodhimit, me qëllim pasqyrimin e numrit dhe kapacitetit të njësive të depozitimit, sipas aplikimit të paraqitur dhe afatit të licencës.
- Me shkresën nr. 2958/1 prot., datë 14.10. 2026, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar depozitimin e informacionit dhe dokumentacionit plotësues që nuk rezultonte i identifikueshëm nga dokumentacioni i administruar më parë, përfshirë të dhënat mbi fuqinë nominale të ngarkimit dhe të shkarkimit të impiantit të depozitimit, të shprehura në MW, si dhe informacionin e përditësuar lidhur me miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes me rrjetin, në rast se shoqëria ishte pajisur me këtë miratim.
- Gjithashtu, në këtë shkresë shoqërisë i është sjellë në vëmendje se në zbatim të regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 dhe në rast të miratimit të regjistrimit të këtij impianti, e drejta e operimit të tij do të njihet deri në përfundimin e periudhës 12-mujore të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, brenda së cilës shoqëria ka detyrimin të aplikojë për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2958/2 prot., datë 26.10.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues.
- Rezulton se kërkesa është paraqitur në kuadër të regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe të Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026. Shoqëria "3X ENERGY" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e administruar në kuadër të procedurës së licencimit të centralit fotovoltaik, si dhe informacionin dhe dokumentacionin plotësues për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 72,0015 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 144,003 MWh. Dokumentacioni i shqyrtuar përfshin, ndër të tjera, informacionin mbi parametrat teknikë të impiantit të depozitimit, dokumentacionin e administruar në kuadër të procedurës së licencimit të centralit fotovoltaik dhe informacionin plotësues të depozituar nga shoqëria me shkresën nr. 2958/2 prot., datë 26.10.2026.
- Për sa më sipër, vlerësohet se plotësohen kushtet për vijimin e procedurës së regjistrimit të këtij impianti në kuadër të licencës nr. 665, Seria P26, të dhënë shoqërisë "3X ENERGY" sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 262, datë 11.09.2026, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 70 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3268, fshati Saver, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.

- Shoqëria ka detyrimin gjatë operimit të centralit fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 70 MW, dhe impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 72,0015 MW, të respektojë kufirin e fuqisë aktive totale të injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin, prej 70 MW, si dhe kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit dhe çdo detyrim tjetër që buron nga legjislacioni në fuqi.
- Shoqëria i nënshtrohet regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, për një periudhë jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Regjistrimi i impiantit gjatë këtij regjimi nuk përbën licencë për ushtrimin e veprimtarisë së operimit të tij. Për vijimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie pas përfundimit të regjimit kalimtar, shoqëria duhet të ndjekë procedurën përkatëse të licencimit në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
- Për këtë vendimmarrje vlerësohet që të njoftohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të regjistrojë impiantin e depozitimit të energjisë elektrike (BESS), të deklaruar nga shoqëria "3X ENERGY" sh.p.k., me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 72.0015 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 144.003 MWh, në kuadër të licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 70 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3268, Fshati Saver, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, njihet dhe lejohet të vijojë operimin, për periudhën kalimtare të përcaktuar në nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".

3. Për operimin e impiantit të depozitimit pas datës 14.07.2027, shoqëria duhet të aplikojë për licencën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

4. Çdo ndryshim në të dhënat e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike duhet të njoftohet nga shoqëria në ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të marrë masat për regjistrimin dhe pasqyrimin e të dhënave të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në Regjistrin përkatës të ERE-s, dhe në Fletën individuale të regjistrimit, në përputhje me rregullat në fuqi, përfshirë cdo ndryshim të këtyre të dhënave të njoftuar nga shoqëria sipas pikës 4 të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "3X Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sisteit të Transmetimit" sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI